

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ 208/24 dhe 16/25), dhe duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga Princ Sub Inc. (Prince Sub Inc.), shoqëri me seli kryesore në adresën 1515 Broadway, New York, New York 10036, Shtetet e Bashkuara të Amerikës përmes Tatjana Popovski, Buloski, avokate nga Shoqëria e Avokatëve Popovski dhe partnerët nga Shkupi, në seancën e mbajtur më datë 20.05.2026, mori këtë:

### **AKTVENDIM**

1.Vërtetohet se përqendrimi me të cilin Princ Sub Inc. (Prince Sub Inc.), shoqëri me seli kryesore në adresën 1515 Broadway, New York, New York 10036, Shtetet e Bashkuara të Amerikës synon të fitojë kontroll të plotë mbi Warner Bros. Discovery, Inc. (Warner Bros. Discovery, Inc.), me seli kryesore në 230 Park Avenue South, New York, NY 10003, Shtetet e Bashkuara të Amerikës përmes shitblerjes së aksioneve, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose cenimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve, dhe është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

2.Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6.000,00 denarë dhe për aktvendimin në shumë prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për Taksat Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 151/21), në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, kodi dhe programi i të ardhurave 72231300.

3.Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e këtij aktvendimi.

### **Arsyetim**

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më datë 26.03.2026, e plotësuar më 21.04.2026 pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim nga Princ Sub Inc. (Prince Sub Inc.), shoqëri me seli kryesore në adresën 1515 Broadway, New York, New York 10036, Shtetet e Bashkuara të Amerikës me të cilin Princ Sub Inc. synon të fitojë kontroll të plotë mbi Warner Bros. Discovery, Inc. (Warner Bros. Discovery, Inc.) me seli kryesore në 230 Park Avenue South, New York, NY 10003, Shtetet e Bashkuara të Amerikës përmes shitblerjes së aksioneve.

Më datë 07.04.2026 Komisioni me konkluzion Pa.nr.08-63 nga: A1 Makedonija SHPKNJP Shkup, Sheshi „Presveta Bogorodica“ nr. 1, Shkup, INEL INTERNACIONAL Kavadar, rr. „Kiro Kërstev“ nr. 8 Kavadar, Shoqëria radiodifuzive tregtare KABEL-NET SHPK Strumicë, rr. „Nevena Stojkova“ nr. 17 Strumicë, Makedonski Telekom SHA Shkup, Keji „13 Nëntori“

nr. 6 Shkup, MTEL SHPKNJP Shkup, rr. „Maksim Gorki“ nr. 11/1-kati 3, Shkup, Shoqëria për shërbime telekomunikuese TELEKABEL SHPKNJP Shtip, rr. „Vanço Përçe“ nr. 88. Shtip, TOTAL TV DOOEL Shkup, rr. „Boris Trajkovski“ nr. 5, Shkup, Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar KDS-KABEL NET Prilep, rr. „Pitu Guli“ nr. 3 Prilep kërkoi të dorëzojnë këto të dhëna: listën e kanaleve televizive të destinuar për fëmijë që i kanë transmetuar, veçmas në vitin 2024 dhe 2025 dhe kompensimin e paguar për blerjen e secilit prej kanaleve për fëmijë veçmas në vitin 2024 dhe 2025 (nëse një kontratë ka të bëjë me blerjen e më shumë kanaleve dhe është paguar një kompensim total, të theksohet kompensimi dhe të theksohen kanalet për të cilat ai është paguar).

Me shkresën tonë Pa.nr.08-63 më 15.04.2026 KDS-KABEL NET Prilep i dorëzoi të dhënat e kërkuara përmes postës elektronike.

Me shkresën tonë Pa.nr.08-63 më 16.04.2026 A1 Makedonija SHPKNJP i dorëzoi të dhënat e kërkuara përmes postës elektronike (më 20.04.2026 i njëjti i dorëzoi të dhënat në origjinal).

Me shkresën tonë Pa.nr.08-63 më 21.04.2026 Makedonski Telekom SHA i dorëzoi të dhënat e kërkuara përmes postës elektronike (më 23.04.2026 i njëjti i dorëzoi të dhënat në origjinal).

Me shkresën tonë PA.nr.08-63 më 23.04.2026 TELEKABEL SHPKNJP Shtip i dorëzoi të dhënat e kërkuara përmes postës elektronike dhe në origjinal.

Me shkresën tonë PA.nr.08-63 më 23.04.2026 INEL INTERNACIONAL Kavadar, i dorëzoi të dhënat e kërkuara në rrugë elektronike (më 29.04.2026 i njëjti i dorëzoi të dhënat në origjinal).

Me shkresën tonë Pa.nr.08-63 më 28.04.2026 KABEL-NET SHPK Strumicë i dorëzoi të dhënat e kërkuara përmes postës elektronike.

Me shkresën tonë Pa.nr.08-63 më datë 04.05.2026 MTEL SHPKNJP Shkup i dorëzoi të dhënat e kërkuara.

Me shkresën tonë Pa.nr.08-63 më 06.05.2026 TOTAL TV SHPKNJP Shkup i dorëzoi të dhënat e kërkuara.

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin për përqendrim, plotësimin, shtojcat e tyre dhe të dhënat e siguruara në mënyrë shtesë konstatoi si vijon:

#### **Aktivitetet themelore afariste të ndërmarrjeve të përfshira:**

**Princ Sub Inc.** është një shoqëri e varur plotësisht e kontrolluar nga Paramount Skydance Corporation (Paramount Skydance Corporation) me seli kryesore në 1515 Broadway, New York, NY 10036, Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Paramount Skydance Corporation është një kompani globale mediatike, streaming dhe argëtuese e cila krijon përmbajtje dhe përvoja për audiencën anëmbanë botës, duke përfshirë filma, seriale televizive dhe animacion.

Në vitin 2024 dhe 2025, Paramount Skydance Corporation ka operuar përmes tre segmenteve të mëposhtme:

- Produksioni i filmave (Filmed Entertainment), i cili përfshin si produksionin ashtu edhe blerjen e filmave dhe serialeve për shfaqje globale dhe licencim, përfshirë në salla kinemaje, në shërbime streaming, në televizion, si dhe përmes formateve dixhitale dhe fizike për argëtim në shtëpi (për shembull, DVD/Blu-ray). Ky segment përfshin Paramount Pictures, Paramount Animation dhe Miramax.
- Mediat televizive (TV Media), i cili përbëhet nga:
  - operacionet e rrjetit televiziv për transmetim (përkatësisht CBS Television Network në SHBA) dhe stacionet televizive të CBS në pronësi të kompanisë në mbarë SHBA-në;
  - rrjetet televizive kabllore në SHBA (përfshirë Nickelodeon, Comedy Central, BET dhe MTV) dhe zgjerimet ndërkombëtare të disa prej këtyre markave; dhe
  - operacionet e studiove televizive në SHBA dhe në nivel ndërkombëtar, përfshirë CBS Studios, të cilat prodhojnë seriale, programe të mbrëmjes dhe ditore, si dhe ekskluzivitete (franchises) si „NCIS“ dhe „Star Trek“.
- Direct-to-Consumer („DTC“), i cili përfshin shërbimet e streaming Paramount+, Pluto TV dhe BET+ (kjo e fundit është e disponueshme vetëm në SHBA). Paramount+ është një shërbim video sipas kërkesës i bazuar në abonim (subscription-based video on demand ose „SVOD“), i cili ofron filma, seriale, emisione dhe përmbajtje të tjera nga markat dhe studiot e Paramount Skydance Corporation, si dhe nga palë të treta. Pluto TV është një shërbim televiziv streaming falas i mbështetur nga reklamat (free ad-supported streaming TV service ose „FAST“), i cili kryesisht ofron kanale FAST me një orar linear programi, si dhe përmbajtje të caktuar shtesë sipas kërkesës nga zhanre të ndryshme.

Paramount Skydance Corporation nuk ka prani juridike në Republikën e Maqedonisë së Veriut, por është e pranishme përmes:

- prodhimit dhe licencimit të të drejtave të shpërndarjes për filma për shfaqje në kinema (në 2024 dhe në 2025), prodhimit dhe furnizimit me përmbajtje audiovizive (AV) (në 2024 dhe 2025), shitjes me shumicë të kanaleve televizive (në 2024 dhe 2025), ofertës me pakicë të shërbimeve audiovizive (SVOD) (në 2024 dhe 2025), zhvillimit dhe publikimit të video lojërave (në vitin 2024) dhe licencimit të të drejtave të pronësisë intelektuale për shitjen e produkteve të markuara (në vitin 2024).

Warner Bros. Discovery, Inc. është një kompani globale mediatike dhe e industrisë së argëtimit e kuotuar publikisht me seli në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, e cila krijon dhe shpërndan një portofol të larmishëm të përmbajtjeve dhe produkteve përmes televizionit, filmit, streaming dhe lojërave interaktive. Portofoli i markave dhe mjeteve të prodhimit të Warner Bros. Discovery, Inc përfshin, ndër të tjera, Discovery Channel, CNN, DC Studios, New Line Cinema, TNT Sports, Eurosport, Max, HBO, Warner Bros. Motion Picture Group („WBMPG“), Warner Bros. Television Group („WBTVG“) dhe Warner Bros. Games.

Warner Bros. Discovery, Inc operon përmes tre segmenteve të mëposhtme:

- Direct-to-Consumer (DTC), i cili kryesisht përfshin Pay-TV dhe shërbimet e streaming.

- Studiot e prodhimit (Studios), të cilat kryesisht përfshijnë prodhimin dhe publikimin e filmave të metrazhit të gjatë për shfaqjen e tyre fillestare në kinema, prodhimin dhe licencimin fillestar të programeve televizive në rrjetet dhe shërbimet DTC të Warner Bros. Discovery, Inc, si dhe për palët e treta, shpërndarjen e filmave dhe programeve televizive të Warner Bros. Discovery, Inc në shërbime të ndryshme televizive dhe streaming të palëve të treta dhe të brendshme, shpërndarjen përmes argëtimit shtëpiak (fizik dhe dixhital), produktet e lidhura të konsumit dhe licencimin e përvojave tematike, si dhe video lojërat.
- Rrjetet televizive (Networks), të cilat kryesisht përfshijnë rrjetet televizive vendase dhe ndërkombëtare të Warner Bros. Discovery, Inc.

Warner Bros. Discovery, Inc. nuk ka prani juridike në Republikën e Maqedonisë së Veriut, por është e pranishme përmes<sup>1</sup>: prodhimit dhe furnizimit me përmbajtje audiovizive (AV) (në 2024 dhe 2025), shitjes me shumicë të kanaleve televizive (në 2024 dhe 2025), ofertës me pakicë të shërbimeve audiovizive (SVOD) (në 2024 dhe 2025), zhvillimit dhe publikimit të video lojërave (në 2024 dhe 2025), sigurimit të hapësirës për reklama televizive (në 2024 dhe 2025) dhe licencimit të të drejtave të pronësisë intelektuale për shitjen e produkteve të markave (në 2024 dhe 2025).

Komisioni konstatoi se përqendrimi i paraqitur bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, pasi i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pikat 1) dhe 2) të Ligjit.

Komisioni, duke pasur parasysh kriteret nga neni 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, edhe bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin apo shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit. Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

---

<sup>1</sup> XXX (të dhënat paraqet sekret afarist)

**Udhëzim për mjetin juridik:**

Kundër këtij aktvendimi mund të ngrihet padi për fillimin e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

**KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS  
KRYETARE**

**Mr. Малинка Силјановска Николиќ**